

NrProt.

Tiranë, me _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF- 88721-06-03-2026

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim, instalim dhe konfigurim i pajisjeve IT, sistemeve të kontrollit të aksesit dhe softuereve”

KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Kompjutera desktop– 30213300-8 Paketa software dhe sisteme informacioni – 48000000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 138,358,000 (njëqind e tridhjetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.ose 1,450,749.71 (një milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë pikë shtatëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Vlerat në Euro në këto dokumente tenderi janë konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 3.6.2026, me kurs këmbimi 95.37.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilat parashikohet se:

Neni 82, i LPP-së, pika 1: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit,

sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP-së: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit të prokurimit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” dhe pikën 1 të nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe

financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sicc është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit të prokurimit, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit të procedurës së prokurimit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së pwrlllogaritur të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben A.K. për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si

referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin minimal të certifikuar:

- a) 1 specialist PMP, Prince2 ose ekuivalent;
- b) 1 specialist ITIL ose ekuivalent;
- c) 2 specialistë të certifikuar nga prodhuesi i serverëve HCI;
- d) 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi i hipervizorit;
- e) 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi i sistemit NAS Backup;
- f) 2 specialistë të certifikuar nga prodhuesi i switcheve;
- g) 2 specialistë të certifikuar nga prodhuesi i sistemeve të kontrollit të aksesit.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 5, shkronja “b”, të Vendimit Nr.285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë personelin teknik dhe stafin kryesor të nevojshëm për realizimin e kontratës.*

Projekti ka për objekt projektimin, zhvillimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të integruar Web dhe Mobile, i cili përfshin infrastrukturën serverike, integrimin dhe konfigurimin e pajisjeve Access Controller, administrimin e bazës së të dhënave, testimin, sigurinë e sistemit, si dhe trajnimin e përdoruesve fundorë. Duke marrë në konsideratë kompleksitetin teknik të projektit, natyrën multidisiplinare të aktiviteteve dhe nevojën për realizimin e tyre sipas standardeve profesionale dhe kërkesave funksionale të përcaktuara, kërkohet angazhimi i stafit të specializuar si më poshtë:

- **Architekt Developer – 1 (një) specialist**, i cili është përgjegjës për projektimin e arkitekturës së përgjithshme të sistemit dhe për garantimin e koherencës teknike ndërmjet të gjitha komponentëve të tij. Përgjegjësitë kryesore të këtij specialisti: Projektimi i arkitekturës logjike dhe fizike të sistemit; Përcaktimi i teknologjive, standardeve dhe metodologjive të zhvillimit; Definimi i mekanizmave të sigurisë, performancës dhe shkallëzueshmërisë; Koordinimi teknik ndërmjet ekipeve të zhvillimit dhe implementimit; Mbikëqyrja e integrimit të aplikacioneve me infrastrukturën serverike dhe pajisjet Access Controller. Angazhimi i këtij specialisti është i domosdoshëm për të garantuar një arkitekturë të qëndrueshme, të sigurt dhe të zgjerueshme, e cila mbështet zhvillimin afatgjatë të sistemit.
- **Frontend Developer – 1 (një) specialist**, i cili është përgjegjës për zhvillimin e ndërfaqes së përdoruesit në platformën Web dhe implementimin e funksionaliteteve që

lidhen drejtpërdrejt me përdoruesin fundor. Përgjegjësitë kryesore të këtij specialist: Zhvillimi i ndërfaqeve grafike dhe funksionale; Implementimi i dizajnit të miratuar UI/UX; Integrimi me shërbimet dhe API-të e backend-it; Testimi dhe optimizimi i performancës së aplikacionit; Garantimi i përpunshmërisë me standardet moderne të përdorshmërisë. Ky rol është thelbësor për sigurimin e një eksperience efikase dhe intuitive për përdoruesit.

- **Backend Developer – 1 (një) specialist**, i cili është përgjegjës për zhvillimin e logjikës së biznesit, shërbimeve qendrore dhe komunikimit ndërmjet komponentëve të sistemit. Përgjegjësitë kryesore të këtij specialisti: Zhvillimi dhe mirëmbajtja e API-ve; Implementimi i proceseve të autentikimit dhe autorizimit; Integrimi me bazën e të dhënave; Integrimi me pajisjet Access Controller dhe sistemet e tjera të jashtme; Zbatimi i mekanizmave të sigurisë dhe monitorimit të sistemit. Ky specialist siguron funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të proceseve kryesore të aplikacionit.
- **Database Developer – 1 (një) specialist**, i cili është përgjegjës për projektimin, optimizimin dhe administrimin e bazës së të dhënave. Përgjegjësitë kryesore të këtij specialisti: Projektimi i strukturës së databazës; Menaxhimi i integritetit dhe konsistencës së të dhënave; Optimizimi i performancës së kërtimeve dhe transaksioneve; Krijimi dhe administrimi i mekanizmave të backup-it dhe rikuperimit; Mbështetja e proceseve të raportimit dhe analizës. Duke qenë se baza e të dhënave përbën komponentin kryesor të ruajtjes dhe administrimit të informacionit, ky rol konsiderohet i domosdoshëm për garantimin e funksionimit të sistemit.
- **Mobile Developer – 1 (një) specialist**, i cili është përgjegjës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e aplikacionit mobil në platformat Android dhe/ose IOS. Përgjegjësitë kryesore të këtij specialisti: Zhvillimi i aplikacionit mobil; Integrimi me shërbimet backend; Implementimi i funksionaliteteve specifike mobile; Testimi në pajisje dhe versione të ndryshme të sistemeve operative; Optimizimi i performancës dhe sigurisë së aplikacionit. Prania e këtij specialisti siguron aksesin dhe përdorimin e sistemit në pajisje mobile, në përputhje me kërkesat e projektit.
- **UI/UX Designer – 1 (një) specialist**, i cili është përgjegjës për projektimin e përvojës së përdoruesit dhe standardizimin vizual të platformës. Përgjegjësitë kryesore të këtij specialisti: Analiza e nevojave dhe sjelljes së përdoruesve; Projektimi i ndërfaqeve Web dhe Mobile; Krijimi i prototipeve, wireframe-ve dhe mockup-eve; Definimi i standardeve grafike dhe elementeve vizuale; Përmirësimi i përdorshmërisë dhe aksesueshmërisë së sistemit. Ky rol kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së përdorimit dhe pranueshmërisë së sistemit nga përdoruesit fundorë.
- **Specialistë IT për Servera dhe Access Controller – 2 (dy) specialistë**, për shkak të nevojës për instalimin, konfigurimin dhe administrimin e infrastrukturës teknologjike, kërkohet angazhimi i dy specialistëve IT. **Përgjegjësitë kryesore të këtyre specialistëve:** Instalimi dhe konfigurimi i serverëve; Administrimi i sistemeve operative dhe shërbimeve përkatëse; Implementimi i politikave të sigurisë dhe monitorimit; Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve Access Controller; Integrimi i pajisjeve me aplikacionin dhe bazën e të dhënave; Mirëmbajtja dhe mbështetja teknike gjatë implementimit dhe operimit. Kërkesa për dy specialistë justifikohet nga

nevoja për realizimin paralel të aktiviteteve në infrastrukturë, testim, konfigurim dhe mbështetje operative në fazat e implementimit.

- **Specialistë për Trajnimin e Përdoruesve – 2 (dy) specialistë.** Pas implementimit të sistemit, transferimi i njohurive dhe aftësive te përdoruesit fundorë përbën një komponent thelbësor për funksionimin efektiv të projektit. **Përgjegjësitë kryesore të këtyre specialistëve:** Përgatitja e materialeve dhe dokumentacionit të trajnimit; Organizimi dhe zhvillimi i sesioneve teorike dhe praktike; Trajnimi i administratorëve dhe përdoruesve fundorë; Ofrimi i asistencës gjatë periudhës së adaptimit; Dokumentimi i procedurave operative dhe praktikave të përdorimit. Angazhimi i dy specialistëve mundëson zhvillimin paralel të trajnimeve për kategori të ndryshme përdoruesish dhe përshpejton procesin e transferimit të njohurive. Kjo strukturë organizative siguron mbulimin e plotë të të gjitha fazave të projektit, duke përfshirë analizën, projektimin, zhvillimin, integrimin, testimin, implementimin, administrimin e infrastrukturës, sigurinë, mirëmbajtjen dhe trajnimin e përdoruesve, duke garantuar realizimin e suksesshëm të projektit në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat teknike të përcaktuara.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto kërkesa nuk krijojnë kufizime të pajustificuara të konkurrencës, pasi janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe janë të domosdoshme për verifikimin e kapacitetit teknik e profesional të operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në procedurë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 8 të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën kritike të pajisjeve dhe sistemeve objekt prokurimi, të cilat përbëjnë infrastrukturë thelbësore të teknologjisë së informacionit, sigurisë fizike dhe logjike të Autoritetit Kontraktor.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është vendosur në funksion të garantimit të origjinalitetit, cilësisë dhe gjurmueshmërisë së produkteve që do të furnizohen në kuadër të kontratës.

Duke qenë se objekti i procedurës përfshin furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve IT, sistemeve të kontrollit të aksesit dhe softuerwve, Autoriteti Kontraktor vlerëson se është e nevojshme të sigurohet që produktet e ofertuara të jenë produkte origjinale, të mbështetura nga prodhuesi dhe të furnizohen nëpërmjet kanaleve zyrtare të shpërndarjes.

Paraqitja e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar shërben për të vërtetuar se operatori ekonomik është i autorizuar të tregtojë, furnizojë dhe mbështesë produktet e ofertuara, si dhe garanton aksesin në mbështetjen teknike, përditësimet e nevojshme, pjesët zëvendësuese dhe shërbimet e garancisë gjatë periudhës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky kriter synon gjithashtu të minimizojë rrezikun e furnizimit me produkte jo origjinale, të përdorura, të rinovuara (refurbished) ose të futura në treg nëpërmjet kanaleve jozyrtare, të cilat mund të cenojnë funksionalitetin, sigurinë dhe jetëgjatësinë e sistemeve që do të implementohen.

Për rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar vlerësohet si e nevojshme, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, me qëllim garantimin e realizimit me sukses të saj dhe mbrojtjen e interesave të Autoritetit Kontraktor. Funksionimi i tyre kërkon standarde të larta besueshmërie, origjinaliteti dhe mbështetjeje teknike nga prodhuesi, për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit gjatë gjithë ciklit të tij të jetës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për pajisjet e ofruara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 6, shkronja “b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në zbatim të këtyre dispozitave, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë dokumentacion teknik që shërben për verifikimin e përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, me qëllim garantimin e realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, kriteri është hartuar në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, të parashikuara në nenin 3 Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, konkretisht parimet e **barazisë në trajtim, transparencës, konkurrencës dhe proporcionalitetit**. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve teknikë nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, pasi përbën një dokument standard të disponueshëm nga prodhuesit e pajisjeve dhe shërben vetëm për qëllime verifikimi teknik.*

Në këtë mënyrë, kriteri siguron një proces vlerësimi objektiv, të krahasueshëm dhe të bazuar në të dhëna teknike të verifikueshme, duke shmangur subjektivitetin në vlerësimin e ofertave dhe duke garantuar përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

Paraqitja e katalogëve teknikë kërkohet me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së pajisjeve të ofertuar me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit.

Duke qenë se objekti i procedurës përfshin furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve IT, sistemeve të kontrollit të aksesit dhe softuerwve, është e domosdoshme që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të verifikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë karakteristikat teknike, funksionalitetet dhe standardet e pajisjeve të ofruara. Katalogët teknikë shërbejnë si dokumentacion objektiv dhe i verifikueshëm për krahasimin e produkteve të ofertuar me kërkesat teknike, duke garantuar transparencë në procesin e vlerësimit dhe duke shmangur çdo paqartësi në lidhje me specifikimet e pajisjeve.

Ky kriter synon gjithashtu të sigurojë që pajisjet e ofruara janë të përshtatshme për integrim në infrastrukturën ekzistuese dhe për realizimin e plotë të funksionaliteteve të kërkuara në kuadër të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe kohëzgjatjes së kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë”, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar/ vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin. Rastet e mosparaqitjes së dokumenteve, paraqitjes së dokumenteve të rreme ose të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT